



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 11, datë 14.01.2021

PËR CAKTIMIN ME SHORT TË RELATORIT PËR PROCEDURËN E VERIFIKIMIT TË PASURISË DHE FIGURËS PËR KANDIDATËT QË KANË KANDIDUAR PËR POZICION DREJTUESI, TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 9, DATË 14.01.2021, TË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në nenet 159, pika 2, 190, pika 2, të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në pikat 2-7, të nenit 32, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në pikën 2, Seksioni A, Kreu V, të Vendimit nr. 171, datë 27.09.2019, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë “Për miratimin e Rregullores për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe për zhvillimin e karrierës së prokurorëve”, i ndryshuar, në nenin 9, pika 4, të Vendimit nr. 200, datë 23.09.2020, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë “Për miratimin e rregullores mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”, si dhe me propozimin sipas relacionit të Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, për numrin e kandidatëve që do t’i caktohen secilit anëtar të këtij Komisioni,

V E N D O S I:

1. Për caktimin me short të relatorit për procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatët që kanë kandiduar për pozicion drejtuesi, të shpallur me Vendimin nr. 9, datë 14.01.2021, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si më poshtë:
 - Artan Madani kandidat për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë, relator Kostaq Beluri.
 - Gentian Habazaj kandidat për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat, relator Alfred Balla.

- Artan Shtrungza kandidat për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tropojë, relator Esmeralda Keshi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



**KRYETAR
GENT IBRAHIMI**

**ZV/KRYETARI
ALFRED BALLA**

**ANËTAR
KOSTAQ BELURI**

**ANËTAR
BUJAR SHESHI**

**ANËTAR
NURIHAN SEITI**

**ANËTAR
SANDËR BECI**

**ANËTAR
VATË STAKA**

**ANËTAR
TARTAR BAZAJ**

**ANËTAR
ESMERALDA KESHI**